



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:243074

Datë: 29.11.2024

Numri i dokumentit: 06527523

C-IV.-14-3210

Paditësi:

R D nga f.sh L K.Prishtinë.

Përfaqësuar nga av.F Sh nga Prishtina.

Kundër

E paditura:

K.B “Liria - Bardhosh”- përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha”, Nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari kryesues Dr.sc.Murat Hulaj, dhe gjyqtarët Hasim Sogojeva dhe Manushe Karaçi anëtare, me dt. 29 nëntor 2024 lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar** kërkesëpadia e paditëses R D me të cilën ka kërkuar që të **NDRYSHOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit nr.PRN144-0127 dt.26 mars 2014.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Me dt.25 prill 2014, paditësja përmes të autorizuarit të saj dorëzoi në Dhomën e Posaçme, padi kundër të paditurës Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), me të cilin ka kërkuar që të ndryshohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit nr. PRN144-0127 dt.26 mars 2014, me të cilin i është refuzuar kërkesa për njohjen e pronësisë mbi një aset të paluajtshëm (pjesë nga ngastra kadastrale nr.. F.P nr., në sipërfaqe prej 0.54.00 ari Zona Kadastrale B KK.L). Në padi ka pohuar se prona nuk ka qenë e evidentuar as në emër të paraardhësit të saj (bashkëshortit H D). Këtu

nuk flitet për evidentim të kundërligjshëm të pronës në emër të NSH-së por për një shitblerje të përmbushur nga ana e blerësit, porse NSH-ja nuk ja ka bërë bartjen. Lidhur me këtë paditësja, kishte paraqitur padi pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe lënda ka mbajtur numrin C.nr.340/03, e pastaj i është drejtuar edhe DHPGJS. Kjo kontratë e shitblerjes është lidhur në mes të Koperativës Bujqësore “Devet Jugoviq” dhe të ndjerit H D (bashkëshorti i paditëses). Obligimi i blerësit ka qenë që çmimin ta paguaj me tri këste, sipërfaqja prej 2.00 ha NSH ia ka bartë në emër të blerësit, kurse sipërfaqen prej 1.45.87 ha jo, dhe tani kjo ngastër mban nr.590. Për këtë blerësi iu ka drejtuar me shkrim Pleqësisë së NSH-së me dt.14.09.1997 por nuk ka marr përgjigje. I ka bashkangjitur këto prova: Kopjen e vendimit të kundërshtuar, Kopjen e kontratës mbi shitblerjen, Kopje e kërkesës e përpiluar me dorë, Kopje e ekstraktit nga fletë posedimi, Tri kopje të faturave.

E paditura e ka paraqitur mbrojtjen e saj me dt.01 nëntor 2023, ku ka pohuar se padia nuk i përmbush kriteret e parapara me ligj. Pala kundërshtare e konsideron se është e rëndësishme të theksohet se objekt i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria e vendimit të AL. Paditësja kishte paraqitur kërkesë pranë AL, kurse AL me dt.26.09.2013 i ka dërguar një kërkesë për të duke i kërkuar dokumente dhe sqarime shtesë. Sipas legjislacionit në fuqi nuk ekziston ndonjë ligj apo dispozitë ligjore për kthimin e pronës tek ish pronarët. Prona kontestuese është e regjistruar në emër të NSH-së. Si bazë ligjore ka përmendur nenin 124 (1) 1 të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore. Kërkuesi edhe pasi ju kërkuar prova shtesë nuk arriti që të vërtetoj faktet mbi të cilat e ngrenë kërkesën pronësore. Ka kërkuar që gjykata ta refuzoj padinë si të pa pranueshme apo të pa bazuar dhe të vërtetoj vendimin e AL-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj lënde ka caktuar dhe ka mbajtur seancat gjyqësore të dt.23.04.2024 dhe të dt.11.11.2024, ku kanë prezantuar të autorizuarit e palëve ndërgjyqësore.

Në seancën e dt.23.04.2024, i autorizuari i paditëses ka mbetur pranë padisë së ushtruar, duke kërkuar nga gjykata që padinë e paditëses ta aprovoj si të bazuar dhe ka bërë dorëzimin e këtyre provave: Kopjen e aktvendimit të trashëgimisë LRP.nr.rendor., Ref:.. dt., Kopjen e certifikatës së pronësisë P-.. dt., Kopja e Përgjigjes e Komunës së Prishtinës – Drejtoria e Kadastrit në Kërkesën mbi të drejtat e pronës dt.18.04.2016, Kopja e formularit të kërkesës për likuidim, Njoftimi i AKP nr.3996 dt.26.03.2013, Kopja e padisë drejtuar Gjykatës Komunale në Prishtinë dt.09.04.2003, Kopjen e padisë drejtuar DHPGJS dt.04.04.2006, Kopja e planit, Mendim dhe Konstatim C.nr.34/03 dt.12.01.2004, Tri kopje të pagesës, Shkresë me dorë.

Në fjalën përfundimtare ka pohuar se paditësi ka ofruar prova të plotë dhe të besueshme për të mbështetur kërkesat e tij, duke përfshirë dëshmi nga ekspertë gjeodet dhe dëshmitar. Familja D ka kaluar dekada padrejtësisht dhe kërkon nga gjykata që të zbatojë drejtësinë.

I autorizuari i të paditurës ka deklaruar se: E kundërshtojë në tërësi kërkesën e parashtruesit, pasi që parashtruesi asnjëherë nuk ka ofruar prova me të cilën dëshmon se pala ankuese e ka këtë pronësi në emër të tyre dhe as që ka qenë në emër të tyre. Dhe e njëjta gjykatës i ja ofroje certifikate pronësore të datës .. lëshuar nga zyra kadastrale në Prishtinë për ngastrën kadastrale numër .. për të cilën pretendon se është e tyre. Gjithashtu se bashku me padinë ka bashkangjitur Mendim dhe Konstatim C.nr.34/03 dt.12.01.2004 ku paditësja R D i është drejtuar Gjykatës

Komunale në Prishtinë për vërtetimin e pronësisë. Gjithashtu ja dorëzoj edhe padinë drejtuar DHPGJS-së me datën 04.04.2006 me numër të lëndes SCC-06-0147 me bazë të njëjtë e cila është vërtetim të pronësisë dhe nga kopja e planit me mendim dhe konstatim të F H te datës 12.01.2004, si dhe disa dokumente shtese ne këtë rast urdhër për pagese dhe një kërkesë qe paraprakisht përfaqësuesi i te paditës theksoje se ju ka adresuar me shkrim N.SH. “Devet Jugovic”. Krahas me rastin likuidimit nga AKP-ja kërkesën qe pala R D- ankuesja i është drejtuar me kërkesës kreditore AL-së. Propozojë që të refuzohet kërkesa e palës kundërshtarë ngase është e pa bazuar në ligj.

Në fjalën përfundimtare ka shtuar, se kërkon nga gjykata që të refuzoj padinë si të pa bazuar, pasi që e njëjta nuk është vërtetuar me prova konkrete të besueshme se prona e paluajtshme e lartpërmendur ka qenë ndonjëherë e regjistruar në emër të tij/ saj apo të paraardhësit, që nga viti i nënshkrimit të kontratës së shitjes.

Në këtë seancë gjykata ka bërë *dëgjimin e G D*, i cili ka deklaruar se: Paraardhësit e në vitin 1968 prindi im H D nga fshati L Komuna e Prishtinës e thirr Kooperativa Bujqësore N.SH “Ish Deved Jugovic” tani “Liria” për t’ia ofruar për shitje dy hektar tokë me arsyetimin se toka ishte e pjerrët dhe po kanë probleme me punimin e saj. Prindi i përgjigjet që e ka gjendjen e dobët ekonomike dhe ata i thonë që mundet të bëjë blerje me këste, dhe kështu pajtohen të dyja palët dhe lidhet kontrata ne vitin 1968, dhe pastaj e paguan këstin e parë dhe në atë kohë e lënë edhe familjen shumë keq ekonomikisht dhe e fton një traktorist i cili ka punua në N.SH për t’ia livruar atë parcelë, emri i traktoristit nuk më kujtohet, por ai ja livroni dhe pas përfundimi të livrimit, me qëllim që ti behet pagesa livruesit i është bërë matja e pjesës së lëvruar dhe traktoristi i thotë prindit tim i ki 1(një) hektar e 45 ndërsa, prindi befasohet dhe thotë a si kam 2 hektar, dhe në atë moment e bënë pagesën dhe i frustruar prindi im po atë ditë shkon në kooperativë, dhe e kërkon M D, B P, dhe takohet me ta për tu sqaruar se janë marr paret për dy hektar dhe jo për 1.45 hektar. Kështu babai im këstin e tret nuk e paguan dhe ju mbeti borxh në shenjë revolte. Në vitin 1975 ajro fotografimit ka qene në komision për fshatin M T dhe e ftojnë babën se nëse se paguan këstin e trete për tokë do ta marrin edhe atë se çka ka paguar. Atëherë prindi frikësohet dhe shkon e bënë pagesën e këstit tretet dhe nuk ja evidentojnë në arkiv por vetëm ia japin një lloj fletëpagese edhe nuk e ka shikuar më. Për këtë edhe mungon pagesa e tretë, pas një kohe të caktuar, prindit i vidhet kuleta me gjithë dokumentacion edhe fletëpagesa humbë, çdoherë Kooperativa ka pas treg edhe ne jemi marr me bujqësi për çdo të marte ai është kthyer aty të pyes për pjesën qe i ka mbet borxh. Ndërsa teposhtën e kemi marr si familje nga demonstratat e këtej politikisht. Në vitin 1997 prindi im bënë kërkesë me shkrim edhe ju thotë që duhet të kompensohet për parcelën që i kanë mbete borxh, dhe i njëjti drejtor R Z pas kësaj kërkesë të tret së bashku M D, B P dhe R Z vijnë dhe na trokasin në derë në kohen e luftës, edhe prindi im së bashku me mua jemi pyet se ku donë me ti dhënë këto 54 ari sepse na ke lodh tu i kërkua. Prindi im i është përgjigjur se mos jeni vanu pak për këtë pune, sepse tani jeni në fund të pushtetit edhe me kanë thënë se ajo është tjetër pune. Prindi ju ka thanë ndeshi në Bardhosh, ose në Bernicë kudo vetëm se mi jepni ato 54 ari qe mi keni borxh. Ne vitin 2007 Kooperativa e ka ndërprerë punimin e tokës dhe kanë ardhur disa persona me livruar ka dal bashkëshortja ime R dhe ju ka thënë që nuk bënë me punua këtu, sepse për me punua ose për me marr qira marrim na. Ndërsa nga vitit 2008 posedoj të gjitha kontratat e lidhura me AKP-në, unë personalisht që i shfrytëzoj me qira dhe ne mesin e tyre edhe sipërfaqja kontestuese 54 ari që është pjesë e parcelës që është

objekt shqyrtimi. Dhe unë për këtë edhe bëjë pagese sepse jam pajtuar për këtë parcele që të paguaj qira. Kërkojë nga ana e gjykatës që rishikohet vendimi i AL-ës dhe të ndryshohet vendimi i AKP-së dhe të me aprovohet sipërfaqja prej 54 ari nga ngastra e cila ka qenë objekt prej 2 ha përkatësisht nga parcela .. fleta poseduese .. e cila aktualisht evidentohet ne emër te N.SH “Liria”

Arsyetimi ligjor:

Kërkesëpadia e paditësit refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 par.2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa par.3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Në bazë të nenit 221 dhe 226 të Ligjit për Punën e Bashkuar (Gaz.Zyrtare e RSFJ nr.53/76), parashihet se: *“nëse paluajtshmëria ka kaluar në pronësi shoqërore edhe pa ndonjë bazë juridike, kthimi i saj mund të kërkohet në afat prej 5 vitesh duke filluar nga dita e marrjes në dijeni, e më së voni në afat prej 10 vitesh”*.

Neni 322 par.1 të LPK *“Në qofte se gjykata në baze te provave të marra (neni 8 i këtij ligji) nuk mund te konstatoj me siguri ndonjë fakt , për ekzistimin e faktit do te përfundojë duke i aplikuar rregullat mbi barrën e provës”*. Sipas nenit 322 par.2, *“Pala qe pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj , po qe se ligji nuk parasheh diçka tjetër”*, ndërsa neni 319 par.1 i po të njëjtit ligj parasheh që *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*,

si dhe par.2 i këtij nenit parasheh që: *“Të provuarit përfshihen në të gjitha faktet që janë të rëndësishme për dhënien e vendimit”.*

Ligji mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike – Pronësore (LMTHJP) në nenin 20 e përcakton se *“E drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgim. E drejta e pronësisë fitohet edhe në bazë të vendimit të organit shtetëror në kushtet dhe në mënyrën e caktuar me ligj”.* Ndërsa neni 33 e përcakton *“Në bazë të veprimit juridik e drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme fitohet me regjistrimin në librin publik ose në mënyrën tjetër përkatëse të caktuar me ligj”*, neni 21 i të njëjtit ligj e përcakton se *“Sipas vetë ligjit e drejta e pronësisë fitohet me krijimin e sendit të ri, me bashkim, me përzierje, me ndërtim në tokën e huaj, me ndarjen e fryteve, me parashkrimin fitues, me fitim të pronësisë nga jo-pronari, me okupim dhe në raste të tjera të caktuara me ligj”*, ndërsa fitimi i të drejtës së pronësisë në bazë të trashëgimisë rregullohet me nenin 36 të të njëjtit ligj, ku përcaktohet se *“E drejta e pronësisë mbi sendin fitohet me anë të trashëgimit në momentin e hapjes së trashëgimisë në pasurinë e të vdekurit, po që se me ligj nuk është caktuar ndryshe”.*

Gjykata pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të lartcekura dhe thënieve të palëve ndërgjyqëse, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Pas administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditëses duhet të refuzohet për arsye se paditësi nuk është posedues i paluajtshmërisë kontestuese, pasi që nuk është vërtetuar se në mes tyre dhe NSH-së ka ekzistuar ndonjë punë e vlefshme juridike si kontratë për fitimin e së drejtës së pronësisë.

Gjykata gjeti se në bazë të Certifikatës së Pronësisë, parcela kontestuese evidentohet në posedim të PSH. Kooperativa Bujqësore N Ju D.S Z”. Andaj, pretendimet e paditësit se është pronar të parcelës kontestuese, janë të pa bazuara dhe të pa vërtetuara. E paditura në mbrojtje me të drejtë ka theksuar se paditësi nuk ka prezantuar asnjë dëshmi për të vërtetuar pretendimet e tij se e ka humbur të drejtën e pronës në ngastrën kontestuese.

Gjykata vendosi të refuzojë kërkesëpadinë e paditësit si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi nga gjendja faktike e vërtetuar më lartë gjeti se prona kontestuese evidentohet në pronësinë shoqërore, konkretisht evidentohet në emër të të paditurës.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës paditëse në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje, pasi që gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e paditësit lidhur me të drejtën e tij në vërtetim të pronësisë në parcelën kontestuese, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

E drejta e pronësisë është e drejtë subjektive e karakterit absolut dhe si e tillë gëzon mbrojtje juridike në të gjitha sistemet juridike dhe se sendet e paluajtshme të cilat janë të regjistruara në

librat kadastrale, vlen supozimi se sendi është në pronësi të personit në emër të të cilit është e regjistruar, mirëpo edhe nëse paluajtshmëria nuk është e regjistruar në emër të atij që kërkon pronësinë, duhet të argumenton se i takon ajo e drejtë. Kështu, gjykata erdhi në përfundim se paditësit nuk arritën të argumentojnë se iu takon e drejta e pretenduar.

Andaj në bazë të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore:

Duke u bazuar në nenin 62 paragrafi 5 i Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme secila palë i bartë shpenzimet e veta. Në këtë lëndë nuk caktohen taksa gjyqësore ngase parashtruesi i padisë e ka paguar të njëjtën më dt.12 gusht 2014.

Këshilla juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Dr.sc.Murat Hulaj gjyqtar kryesues,

Manusha Karaqi gjyqtar,

Hasim Sogojeva gjyqtar,